

DEKLARATË PËR MEDIA

Konkluzionet e takimit të shoqërisë civile të Prizrenit me palët relevante rreth projekt-ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, të mbajtur më 25 gusht 2011 në Prizren

26 gusht 2011, Prizren

Pas refuzimit të projekt-ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit nga Kuvendi i Kosovës, shoqëria civile e Prizrenit ka ftuar një takim gjithëpërfshirës për të diskutuar rreth procesit të deritanishëm dhe hapave të ardhshëm rreth këtij projekt-ligji. Pjesëmarrës të takimit ishin përfaqësues të organizatave jo-qeveritare, komunitetit artistik, Kuvendit të Kosovës, Komunës së Prizrenit, komunitetit afarist, medieve, Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve dhe banorë të Qendrës Historike të Prizrenit.

Shoqëria civile i ka prezantuar shqetësimet e veta në lidhje me këtë proces. Disa nga shqetësimet kryesore janë:

- Procesi i hartimit të këtij projekt-ligji, që zgjat rreth dy vjet, ka dëshmuar për qasjen përjashtuese të institucioneve shtetërore të Kosovës dhe faktorit ndërkombëtar ndaj shoqërisë civile dhe qytetarëve kur bëhet fjalë për trashëgiminë kulturore.
- E gjithë përmbajtja e projekt-ligjit përbëhet nga ndalesa, ndëshkime, procedura, emergjenca, favorizime dhe mbindërtime institucionale, ndërsa qendra historike e Prizrenit ka nevojë për një ligj që fut menaxhimin urban si koncept të ruajtjes dhe zhvillimit
- Kisha Ortodokse Serbe është e favorizuar në raport me të tjerët. Edhe pse në dukje të parë lihet përshtypja se ky projekt-ligj konsideron të barabartë të gjitha komunitetet fetare, përmbajtja e projekt-ligjit i jep një zë shtesë Kishës Ortodokse.

Në këtë takim, të gjithë pjesëmarrësit u pajtuan me rekomandimet e mëposhtme të shoqërisë civile:

1. Hartimi i tekstit të projekt-ligjit nga fillimi

- Teksti aktual i projekt-ligjit ka të meta serioze. Nëse punohet mbi këtë version, ka mundësi të përfundojmë me një përmbajtje edhe më të dobët dhe problematike, si pasojë e akomodimit të kërkesave dhe interpretimeve të shumta dhe të paragjykuara
- Hapi i parë duhet të jetë dakordimi i parimeve themelore mbi të cilat duhet të hartohet Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit (pse ka nevojë për këtë ligj, cilat janë modelet ekzistuese dhe funksionale në botë, koncepti i menaxhimit urban të qendrave historike, etj.)
- Në bazë të parimeve themelore, Grupi Punues duhet të fillojë nga e para hartimin e projekt-ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit

2. Themelimi i Grupit Ndërsektoral Punues për hartimin e projekt-ligjit

- Sponsorizimi i projekt-ligjit të bartet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Ministrinë e Kulturës, Departamentin e Trashëgimisë Kulturore
- Për shkak të natyrës ndër-disiplinare të menaxhimit të qendrave historike (dhe menaxhimit urban), Ministria e Kulturës duhet të themelojë Grupin Ndërsektoral Punues, i cili do të udhëheqë procesin e hartimit të projekt-ligjit
- Përbërja e Grupit Punues: Ministria e Kulturës, Ministria e Planifikimit Hapësinor, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, Komuna e Prizrenit, shoqëria civile, ekspertë të pavarur të trashëgimisë kulturore, planifikimit hapësinor, menaxhimit urban
- Marrja për bazë e Strategjisë për Konservim të Integruar të Trashëgimisë Kulturore (dokument i hartuar nga MKRS) si udhërrëfyes për procesin e hartimit të projekt-ligjit

3. Konsultime publike me palët relevante

- Pas përpilimit të draftit të parë të projekt-ligjit, Grupi Punues duhet të nisë procesin e konsultimeve publike me të gjitha palët relevante, e posaçërisht me ato që do t'i ndiejnë pasojat e këtij ligji në përditshmërinë e tyre shoqërore, ekonomike dhe kulturore
- Palët relevante që duhen konsultuar:
 - o OJQ-të e kulturës dhe trashëgimisë kulturore në Prizren
 - o OJQ-të e Prizrenit që veprojnë në fusha të tjera dhe të përafërta
 - o Shoqatat afariste
 - o Pronarët e shtëpive
 - o Komuniteti artistik

4. Konferencë ndërkombëtare

- Rekomandimet që dalin nga procesi i konsultimeve publike do të prodhojnë draftin e dytë të projekt-ligjit
- Ky draft do të jetë material bazë për punimet e një konference ndërkombëtare për të validuar përfundimisht përmbajtjen e tij (respektimi i standardeve ndërkombëtare të trashëgimisë kulturore, menaxhimi urban dhe funksionaliteti, zhvillimi lokal ekonomik, etj.)
- Pjesëmarrës të konferencës:
 - o Menaxherë urban të Qendrave Historike nga qytete evropiane
 - o Ekspertë ndërkombëtarë të trashëgimisë kulturore (akademia, ligji ndërkombëtar, institute kërkimore, organizatat ndërkombëtare)
 - o Organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë
 - o Institucionet shtetërore të Kosovës (qendrore dhe lokale) dhe institutet e agjencitë e specializuara (KKTK, IKMM, IKPH, IAK, etj.)
 - o Ekspertë vendorë të trashëgimisë kulturore, planifikimit hapësinor, menaxhimit urban, historisë
 - o Shoqëria civile dhe palët e interesit

Nga diskutimet e takimit u propozua dhe u miratua iniciativa për organizimin e një peticioni me qytetarët e Prizrenit (veçanërisht me banorët e Qendrës Historike të Prizrenit) në mbështetje të rekomandimeve të lartpërmendura, dhe posaçërisht në mbështetje të kërkesës për hartimin e këtij projekt-ligji nga fillimi dhe pjesëmarrjen e qytetarëve të Prizrenit në të gjitha fazat e procesit të hartimit të projekt-ligjit. Po ashtu në takim iu bë thirrje Kuvendit Komunal të Prizrenit që të thërrasë një takim të jashtëzakonshëm për të diskutuar rreth procesit të hartimit të projekt-ligjit dhe për të qenë bartëse e këtij procesi bashkë me qeverinë e Kosovës dhe institucionet tjera relevante.

Pjesëmarrës të takimit ishin: Ruzhdi Rexha, nën-kryetar i Komunës së Prizrenit, Kreshnik Basha, Instituti Demokratik i Kosovës – dega në Prizren, Nait Hasani, deputet i Kuvendit të Kosovës, Besnik Krajku, afarist, Lulëzim Kabashi, asambleist i Komunës së Prizrenit, Rrahim Morina, qytetar i Prizrenit, Shkëlzen Maralushaj, qytetar i Prizrenit, Iftiman Lutfiu, arkitekt, Jusuf Xhibo, Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve Prizren, Aliriza Arënlju, Dokufest, Doruntina Ukimeri, NGOM, Ramadan Baraliu, gazetar, Erkan Vardari EUIRC, Eroll Shporta, Dokufest, Valon Xhabali, EC Ma Ndryshe, Dren Marseli, X40/40 Bunar, Bashkim Gashi, KMLDNj, Arsim Gjinovci, qytetar i Prizrenit, Arben Shala, Fondacioni për Trashëgimi Kulturorë, Hajrulla Çeku, EC Ma Ndryshe, Bahri Zenelaj, ATTA, Shend Kabashi, Komuna e Prizrenit.